

Çdo qenie njerëzore le ta dëshmojë, le ta dijë, le të flasë, se ky është fundi i çdo gjëje, pra vdekja, për të udhëtimi ka përfunduar më. Ajo (vdekja) është ndarje e tij prej së kësaj bote, ndarje nga frymëmarrjet, ndarje nga shpirti, ndarje nga gjymtyrët e trupit, syri nuk shikon, as dora nuk lëviz, veshi nuk dëgjon, as frymëmarrja nuk funksionon, e as gjaku nuk qarkullon, arteriet nuk i shihen, ky është pikëllim i fundit me të cilën ballafaqohet, çdo i vogël dhe i madh, çdo i largët dhe i afërt. Vdekja është e vërtetë, të cilës nuk ia dinë rëndësinë, mirëpo njerëzit janë të pakujdesshëm dhe ende vazhdojnë në pakujdesi, edhe duke qenë kështu, çdo i gjallë, rruga e të cilit është vdekja dhe ndarja e tij nga kjo botë, rrugë me të cilën i vdekuri braktisë dhe ia lë All-llahut familjen, pasurinë dhe dhuntitë, dhe familja e tij e mbulon me dhë, pasi që i është shuar jeta.

„... E, sikur t'i shihje mizorët kur janë në agoni të vdekjes, e engjëjt kanë shtrirë duart e veta (me ndëshkim) e (u thonë): „Shpëtojeni pra vetveten (nëse mundeni) ‘...’”. (El-En'âm: 93)

Vdekja është një e ardhme e prerë, ajo as nuk merr leje nga sunduesit dhe nuk pret asgjë përveç leje nga All-llahu i Lartësuar. Po, gjithsesi, All-llahu është betuar se do t'i dënojë mbretërit dhe me anë të vdekjes ua then shpinat atyre, kjo është e vërteta e dhembshme, ... kjo është e vërteta e dhembshme. ...

*Mos e prit Ditën kur do të shpaloset e fshehura.*

*Gjithsesi do të zgjohesh në atë Ditë në të cilën të fshehurat do të dalin në shesh, dhe do ta përkujtosh fjalën time në Ditën kur ajo nuk bën dobi.*

Të dashur, njëherë hipëm në automjetin e ndihmës së shpejtë edhe shkruam në shtëpinë e një të riut. Hipëm në katin e dytë të shtëpisë së tij, e gjetëm një të ri të cilit i kishte dalur shpirti dhe kishte vdekur, e te koka i qëndronte nëna e tij duke qajtur, qanin edhe motrat dhe vëllezërit, për shkak se kishin humbur të dashurin. Ishte një pamje tronditëse. E dërguam të vdekurin me automjetin e ndihmës së shpejtë në spital që të vërtetojmë shkakun e vdekjes, e futëm kufomën te mjeku, e ai e zbuloi trupin e tij, e pasi që e zbuloi atë, pa diç të çuditshme tek ai dhe doli me keqardhje nga morgu. I thamë: Ç'është puna me ty, o mjek? Tha: A nuk e dini? I thamë: Jo, Vall-llahi. (Mjeku) Tha: Urdhëroni të hymë brenda tek i vdekuri. Pasi që hymë tek ai, mjeku mori dhe e zbuloi trupin e të vdekurit me ç'rast pamë nën barkun e tij gjilpëra të narkotikëve.

Ai kishte marrë dozë të tepërt të drogës e cila kishte shkaktuar plasjen e enëve të gjakut në tru. Ky me të vërtetë është përfundim i keq edhe argument për këtë është fjala e të Dërguarit, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, ku thotë: „Veprat vlerësohen sipas përfundimit” - e lusim All-llahun për ne dhe për ju që të kemi përfundim të mirë.

*„A mundesh ta kthesh atë të cilit i kaluar jeta, devijimi është i qartë, njeriu i mençur nuk e sheh si urtësi”.*

Të përmendim një rast i cili ndodhi në qytetin e Rijadit. Tre të rinjë ishin duke vozitur një veturë në një prej autostradave me shpejtësi të madhe me ç'rast ndodhi ndeshje. Prej atyre që ishin në veturë dy vdiqën dhe i treti ishte në prag të vdekjes, dikush prej të pranishmëve nxitoi t'ia përkujtojë fjalën La ilahe il-lall-llah, e ai ia ktheu duke qajtur: *Unë jam prej banorëve të zjarrit, unë jam prej banorëve të zjarrit*, derisa vdiq duke i përsëritur këto fjalë. Me siguri do ta kërkojë kthimin... **„E kur ndonjërit prej tyre i vjen vdekja, ai thotë: „O Zoti im, më kthe”.** (El-Mu'minun: 99)

*Dhe e lanë të vetmuar trupin tënd të pajetë, dhe për ty qanin lotët e syve.*

*Mjer për mua si do të jetë halli im kur të më varrosin.*

Shpejto vëlla, shpejto me pendim, mos i le rrugë shejtanit për të shmangur

nga rruga e drejtë... shpejto vëlla para se të vijë dita kur do të thuash:

**„... O i mjeri unë që kam lënë mangu respektimin ndaj All-llahut dhe që kam qenë prej atyre që talleshin!”** (Ez-Zumer: 56)

I Dërguari, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, iu drejtua një personit duke i thënë: „Shfrytëzoi pesë gjëra para se të vijë pesë të tjera: Rininë para pleqërisë, shëndetin para sëmundjes, pasurinë para varfërisë, kohën e lirë para se të jeshë i zënë dhe jetën para vdekjes”.

*Kjo është jeta ime që kaloi në mëkate, ah i mjeri unë sikur të isha kthyer përsëri.*

Do të tregoj vëlla edhe dy ndodhi... Bëhet fjalë për një mjek kardiolog, pra, veni re, kardiolog, nuk mundet çdonjëri ta kryejë këtë funksion, është punë e rëndë. Mjeku gjatë punës së tij tregon për rastet e pacientëve të cilët kanë vdekur në duart e tij dhe si ka qenë përfundimi i tyre. Thoshte se aq shumë vdiqën sa që fillolla t'i njoh shenjat e vdekjes. Mjeku rrëfen rastin për momentin kur i vjen melekui i vdekjes t'ia merr shpirtin.

Një rast i tillë është kur te një pacient i moshuar u vërejtën shenjat e përfundimit të jetës së tij, iu afrua mjeku përballë tij duke e përkujtuar dëshminë *La ilahe il-lall-llah*, ngase I Dërguari, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, thotë: „*Kush e përfundon këtë jetë duke thënë fjalën e fundit La ilahe il-lall-llah hyn në Xhenet*”. E paci-enti e shikonte mjekun me një pamje të çuditshme. E mjeku sërish iu afrua paci-entit që ta dëgjonte mos vallë po e thotë ai dëshminë. Pacienti iu drejtua mjekut me këto fjalë: „O mjek, po të kuptoj se ç'po kërkon prej meje, por nuk mund ta shqiptoj”.

Mjeku tregon një rast tjetër për një person të cilit ngjashëm i ishin afruar momentet e fundit të jetës, gjithashtu edhe atij ia përkujtonte fjalët e dëshmisë duke shpejtuar, ndërsa pacienti i buzëqeshur ia ktheu mjekut duke i thënë: „O mjek, a harrove se duhet ta zgjatish fjalën *La ilahe il-lall-llah*”, dhe vdiq në këtë gjendje (duke e zgjatur dëshminë). I lartësuar qoftë All-llahu, i miri që është në prag të vdekjes e përmirëson gabimin e atij që ia përkujton. Kujdeset për shqiptimin e drejtë të shehadetit. **„E kur ndonjërit prej tyre i vjen vdekja, ai thotë: „O Zoti im, më kthe, që të bëj vepra të mira e ta kompensoj atë që lëshova!”** (El-Mu'minun: 99)

Dhe i përgjigjet All-llahu, subhanehu ve tealâ, duke thënë: „... **Kursesi**, (kthim nuk ka) **e kjo është vetëm fjalë që e thotë ai...**” (El-Mu'minun: 99)

Mirëpo ai këtë e thotë pasi që i ka kaluar jeta, e mjafton vdekja të jetë këshillë. Pasi që të vdes ndonjëri, hudhet ujë mbi, vendoset i shtrirë, lahet trupi, pastaj qefinoset. O Zot na mëshiro, atëherë kur do të na lajnë familjarët. O Zot na mëshiro atëherë kur t'na qefinosin. O Zot, na mëshiro kur do të na bartin mbi supet e tyre dhe kur të vendoset kufoma para imamit... pastaj ia falin namazin e xhenazes... I janë ndërprerë lëvizjet, i janë shuar rrahjet e zemrës, është shndërruar në trup të palëvizshëm, pa shpirt, sikur kurrë nuk ka jetuar. O rob i All-llahut, parafytyro veten të ishe i vdekur, paramendoj këto momente kur njerëzit do ta falin xhenazen, këto janë momente të vështira, paramendoje veten, të jeshë i shtrirë, si do të ishte? Ku është kthimi yt, ç'farë janë dëshirat tua? Parafytyro, se si muslimanët janë duke ta falur xhenazen... Ke kujdes për këto gjëra...

Transmetohet nga Enes ibn Maliku, radiall-llahu anhu: „Ditën kur erdhi i Dërguari, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, çdo gjë ndriçoi në Medinë. E pasi që ndërroi jetë Muhammedi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, errësira kaploi çdo gjë dhe All-llahu mori nga duart tona njeriun më të çmuar? Jeta na u bë e idhët pa të”.

**Vdekja e Pejgamberit, sal-lall-llahu alejhi ve selem.**

**„Ti do të jesh i vdekur, e edhe ata do të jenë të vdekur”.** (Ez-Zumer: 30)

Fatkeqësia me e madhe që i kaploi muslimanët ishte vdekja e Muhammedit, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem. Prej të gjitha fatkeqësive tona, më e pakrahasueshme është vdekja e të dërguarit, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, vdekja e cila shkëputi lidhjen me Qiellin deri në Ditën e Gjykimit. Me vdekjen e tij u ndërpre shpallja, me vdekjen e tij u përhapën trazirat, shumë prej fiseve arabe ia kthyer shpinën fesë, me vdekjen e tij filluan të këputen hallkat në zinxhirin e quajtur Islam? Ky është kulminacioni i fatkeqësive që godet robin në veçanti apo shoqërinë në përgjithësi. E ky është i Dërguari, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, që kërkon prej neve që sprovat tona t'i krahasojmë me sprovën e vdekjes së tij, dhe në këtë mënyrë i tejkalojmë fatkeqësitë. I Dërguari, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, në hadithin të cilin e vërtetoi shejh Albani, rahmetull-llah alejhi, në veprën e tij „Sil-Sileh”, thotë: „Nëse ju ndodh ndonjë fatkeqësi, përkujtoni fatkeqësinë e vdekjes time, sepse ajo me të vërtetë është më e madhe”.

Transmetohet nga Enes ibn Maliku, radijall-llahu anhu, i cili thotë: „Kur iu shtuan dhimbjet e kaploi agonia të Dërguarin, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem... përjetonte mundime të mëdha... ishte në agoni të rëndë të vdekjes... mbi të qoftë falja dhe shpëtimi i All-llahut... E Fatimja, radijall-llahu anhu, tha: Vaj për babain tim në këtë agoni, pastaj i Dërguari, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, tha: „Nuk ka më babai yt brenga pas kësaj dite”. Sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, pasi që vdiq, Fatimja, radijall-llahu anhu, tha: O Babai im, iu përgjigje thirrjes së Zotit. O babai im, Xhenetin e Firdeusit vendbanim e ke. O babai im, për vdekjen tënde Xhibrilin do ta lajmërojme.

Vdekja e të Dërguarit, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, është prej fatkeqësive të kësaj feje. Të vdekurit e çdo njeriu nuk mund të krahasohet me atë të Dërguarit, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem. O ti shpirt, a edhe pas vdekjes Mustafasë, po lakmon? Pas jetës së kësaj bote, jo assesi, edhe pse s'ke rrugëdalje nga ajo (vdekja).

*...I erdhi vdekja atij që nuk dua t'i vjen, e në sy lotë nuk më kanë mbetur,*

*sepse lotët mbi faqet e mia vetëmse kanë rrjedhur... .*

*Ngadalë me lotët që mos t'i thashë, ngase para teje ka të qarë të gjatë.*

Në të kaluarën sa vëllezër kemi përcjellë, apo të afërm, sa të dashur dhe miq kemi humbur, na ka dridhur dhe befasuar lajmi për ta, derisa vërtetësia e atij lajmi nuk ka lënë shpresë. Kanë qenë në krye të tubimeve edhe të afërt me bashkëbiseduesit, na parakaluan në varreza, dhe pas nesh lanë ata që interesohen për Fe dhe ata për dunja, andaj o Zoti ynë, lësho mbi varrezat e tyre retë e mëshirës dhe kënaqësisë Tënde. O Zot, mos na e privo prej shpërbllimit të tyre dhe mos na provo pas tyre, na fal neve dhe ata. E All-llahut është atë që e merr dhe e Atij është atë që e jep dhe çdo gjë te Ai është me afat të caktuar. Shejh Ibn Bazi, rahmetull-llah alejhi, me një rast shfrytëzoi këshilloi vëllezërit: Ju këshilloj ngase çështja e vdekjes është e rëndësishme dhe se është obligim për çdo besimtar që të angazhohet në fenë e All-llahut, pse po e injorjmë exhelin, ndodh që ajo ju vjen në mëngjes, ndoshta gjatë ditës ose para perëndimit të Diellit, ndodh të jeshë në automjet me familjen e të bësh ndeshje e të vdesish, edhe ne jemi dëshmitarë për këto raste që ndodhin, prandaj obligohemi të kemi kujdes.

Mbahet kufoma mbi supet e njerëzve edhe dërgohet deri te varrezat, kufoma flet ashtu siç na ka sqaruar i Dërguari, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem: „*Edhe kur sillet kufoma e mbajnë njerëzit mbi supet e tyre, e nëse ka qenë prej të mirëve ai thotë: Shpejtoni me mua, e nëse është jo i sinqertë ai thotë: Ah i mjeri unë, ku jeni duke më çuar mua, e dëgjon zërin e tij çdo send përveç njerëzve e sikur ta dëgjonin njerëzit*

do të alivanoseshin". E shoqërojnë kufomën një grup njerëzish deri te varrezat.

E në varr asnjëri nuk hyn me postin tij, a ke dëgjuar se ndonjë epror ka hyrë në varr me gradat në supet e tij, apo nga drejtori me stafin e tij, apo tregtari me mallin e tij, jo nuk do të hynë. Ku është pasuria ime, ku janë pallatet e mia, ku është prona ime, pasuria e patundur, ku janë dashamirët e mi, ku janë shoqëria dhe partia ime, të gjithë u larguan nga unë.

**„Dhe ato do të prezantohen para Zotit tënd të rreshtuar** (e u thuhet atyre): **„Na erdhët ashtu, si ju krijuam juve herën e parë...”** (El-Kehf: 48)

Do të dalin, i pasuri, i varfëri, i forti, i dobëti, udhëheqësi dhe i udhëhequri, sunduesi dhe i sunduari, të gjithë do të dalin në Takimin zyrtar e të vetmuar para All-llahut, e kjo është vdekja.

O vëllai im, e çka do të veprosh nëse të vijnë para asaj dy melekë edhe do të ulin e t'i do të jesh i trishtuar, e do të pyesin: Kush është Zoti yt? Cila është feja jote? Cili është i Dërguari yt?

**„Dhe ruajuni një ditë kur në të ktheheni te All-llahu, dhe secilit njeri i plotësohet ajo që e ka fituar, dhe atyre nuk u bëhet e padrejtë”.** (El-Bekare: 281)

I Dërguari, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, thotë: „*Tre gjëra e përcjellin të vdekurin, dy kthehen dhe një mbetet. E përcjellin familja, pasuria dhe veprat e tij. Kthehen familja dhe pasuria, dhe mbesin veprat e tij*”. Krahasoi o vëlla, në mes periudhës së jetës së kësaj botë dhe asaj jete të amshuar. Jeta e pjesëtarëve të ummetit të Muhammedit, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, do të zgjasë ndërmyet gjashtëdhjetave dhe shtatëdhjetave, kjo është dëshmi për atë të cilin ende nuk e goditur vdekja. Kur vdes më nuk ka kohë për të bërë vepra, a ke medituar kur njerëzit do të lëshojnë ty në varr.

Vari me të vërtetë ka një shtrëngim të madh, asnjëri nuk do të shpëtojë, qoftë i pasur apo i varfër, i mirë ose i prishur, i lart më post ose i ulët, nëse do të shpëtonte ndonjëri ai do të ishte Sad ibn Muadhi.

Atëherë kur do të lësh çdo send, familjen tënde, pasurinë tënde, prindërit dhe vëllezërit, shokët, nuk do të bëjnë dobi, përveçse veprat tua të mira.

*Një ditë patjetër do t'i dorëzohesh varrit,*

*dhe do të qëndrosh në të i paluar deri në Ditën e Ringjalljes.*

O vëlla, thotë i Dërguari, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem: „*Varrin mund të jetë kopsht prej kopshteve të Xhennetit, ose gropë prej gropave të zjarrit*”. Doli Ali ibn ebi Talibi, radially-llahu anhu, me disa shokë të tij te varret, dhe kur u ndal pranë varrezave tha: „O ju banorë të varreve, na tregoni për ju ose ne t'ju tregojmë për ne. Lajmi i atij që është me ne është se pasuria është ndarë, gratë ju janë martuar, vendbanimet tuaja i ka banuar dikush tjetër”. Pastaj heshti një çast, u kthye kah shokët dhe u tha atyre: „Sikur të kishin folur edhe këta, do të na kishin thënë: **... Dhe përgatituni me furnizim** (për rrugë), **e furnizimi më i mirë është devotshmëria...**” (El-Bekare: 197)

Thotë i Dërguari, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem: „Kur vdes njeriu i ndërpritet vepra e tij, përveç në këto tri raste: Sadakaja rrjedhëse, dituria me të cilën përfitohet ose fëmija i cili do të lutet për të”. O vëlla kjo është thirrje e sinqertë prej All-llahut, subhanehu ve tealja, i Cili thotë: „**Thuaj: „O robërit e Mi, të cilët e keni ngarkuar me shumë gabime veten tuaj, mos e humbni shpresën ndaj mëshirës së All-llahut, pse vërtetë All-llahu i falë të gjitha mëkatet, Ai është që shumë falë dhe është mëshirues!”**” (Ez Zumer: 53)

O vëlla i dashur, pendohu tek All-llahu, ndjeje shijen e pendimit, përjetoje ëmbëlsinë e lotëve, shtrydhe zemrën dhe ndjeje dhembjen, që të rrjedh loti mbi faqe, që me të t'i shuash zjarret e mëkateve, vetmohu, pranoe gabimin, lute Zotin dhe thuaj: Ne pendohemi, Ti pranoje, ne pendohemi, Ti na fal, kërkojmë falje.

## Klubi studentor

Lute Zotin dhe thuaj: „O Zot, ne të lutemi me lutje të nevojtarëve, kemi shpresë të Ti, shpresë të të frikësuarve, shpresë të atyre që u janë shtuar mëkatet dhe kanë pak sevape, që i kanë kapluar mëkatet, dhe nuk kanë gjetur të mëshirshëm tjetër pos Teje, e nuk kanë gjetur ndihmës tjetër pos Teje, o më i Mëshirshmi”.

Thuaj, lute Zotin: „O Zot, unë i kam bërë vetes shumë padrejtësi dhe nuk i falë mëkatet askush pos Teje, më fal mua me një falje prej Teje dhe më mëshiro më të vërtetë Ti je Falës dhe Mëshirues”.

**„E pse të mos pendohen dhe të kërkojnë te All-llahu falje, kur All-llahu dihet se falë shumë, është Mëshirues?”** (El-Maide: 74)

Dhe të mos thotë askush: „All-llahu nuk ka caktuar që unë të pendohem”, e nëse thotë ashtu ne i themi: „Nëse ti e kërkon pendimin do ta gjeshe”. All-llahu në hadith kudsij thotë: „**O robërit e Mi të gjithë jeni të humbur përveç atij të cilin e kam udhëzuar, kërkonte udhëzimin Unë ju udhëzoj**”. Apo mos vallë je duke e prit-ur udhëzimin në pjtë të artë e nëse do ta kisha tërhequr vërejtjen për diçka, ajo do të ishte fjala „pastaj”. Mos thuaj pastaj do të pendohem, ngase ti nuk e din kur do të vdesish.

**„O biri Ademiti, sikur të më vije me mëkate sa madhësia e tokës, e pastaj Më takon duke mos më shoqëruar asgjë, do të të pres me po aq shumë falje”.**

**„Përkufizojë veten tënde me ata që lusin Zotin e tyre mëngjes e mbrëmje, e që kanë për qëllim kënaqësinë** (razinë) **e Tij, dhe mos i hiq sytë e tu prej tyre e të kërlesh bukurinë e kësaj bote dhe mos lu bind atij që ia kemi shmangur zemrën e tij prej përkujtimit ndaj Nesh dhe i është dhënë epshit të vet, pse puna e tij ka mbaruar”.** (El-Kehf: 28)

E nëse e do Xhennetin, atëherë mundohu t'i shoqërosh ata të cilët kur t'i shohish të nxisin në përkujtimin e All-llahut. Kur të flasin me ty flasin vetëm të mira, ndërsa rri larg nga shokët e këqij.

*Ka anuar dielli i jetës ime  
dhe i është afruar perëndimit...*

*Nata më ka kapluar kohën*

*kurse mëngjesi i thimjes, vetëmse ka ardhur...*

*O Zot, më shpëto se jam fundosur në detin e mëkateve*

*E më kaplo me falje, o Ti që je më afër se çdo krijesë që është afër meje*

Pasi të lexoni këtë broshurë, mundësojani të tjerëve të lexojnë të njëjtën. Dhe keni kujdes, fletushka përmban ajete kur'anore, andaj ndalohet hyrja me të në vende të ndotura, gjegjësisht në toalet si dhe në vende të ngjashme.

Boton:

Shoqata Qytetare

Klubi Studentor

Rr. Stiv Naumov 7 / 18

Tel. ++389 (02) 32 23-654

1000, Shkup



# V D E K J A

## e vërtetë e jo iluzion

**S**igurisht ndjen vetmi, braktisje, e ndoshta humbje në diturinë e pafund dhe në enigma të pasqaruara. Ndoshta të kapë panikë para sprovave të jetës, para çudirave të vdekjes, dhe para varrit të cilit nuk mund t'i ikin askush prej njerëzve, bile edhe ty të pret... edhe ty të pret **VDEKJA!!!**

I Dërguari i All-llahut, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, thotë: „*Është afruar Momenti i Fundit, njerëzit nuk po ndalen së lakmuari pas kësaj bote (dunjasë) dhe çdo ditë e më tepër largohen prej All-llahut*”. Thotë All-llahu [subhanehu ve tealja]: „*Ju njerëz dinie se jeta e kësaj bote nuk është tjetër vetëmse lojë, kalim kohe në argëtim, stoli, krenari mes jush dhe përpjekje në shtimin e pasurisë dhe të fëmijëve...*” (Hadid: 20)

O ju që e kaloni kohën në argëtim dhe zbavitje, o ju që shitët të përdetshmen me atë që është kalimtare, që këtë botë e shihni si qëllim i fundit i shpresave dhe kulminacioni i shpërblimit, o ju të cilët garoni pas kësaj bote dhe bukuritë e saj të kalueshme, dëgjoni se çka na rrëfen i Dërguari, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem: „*Ma ofroi Zoti luginën e Bat'ha-së (luginë e Mekkes) me ari, e unë i thashë: Jo, o Zot, unë prej Teje kërkoj të ngopem një ditë dhe të mbetem i uritur një ditë, atëherë kur do të uritem do të drejtohem me lutje dhe atëherë kur të ngopem do të të falënderoj*”.

A dëgjuat! O ju që u mashtruat pas ushqimeve të shijshme, mendoni për ngopjen e barkut dhe u mashtruat me dunjanë dhe bukuritë e saj: „**O ju që besuat, as pasuria e juaj e as fëmijët tuaj të mos u shmangin prej adhurimit ndaj All-llahut, e kush bën ashtu të tillët janë mu ata të humburit. Dhe jepni nga ajo që ne u kemi dhënë juve, para se ndonjërit prej jush t'i vijë vdekja e atëherë të thotë: O Zoti im, përse nuk më shtyre edhe pak afatin** (e vdekjes), **që të jepja lëmoshë e të bëhesha prej të mirëve!**...” (El-Munafikunë: 9-11)

I Dërguari, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, ka thënë: „*Sikur ta dinit atë që e di unë do të qeshnit pak e do të qanit shumë*”. Pasha All-llahun që pos Tij nuk ka tjetër, sikur ta dinim realitetin e vdekjes, trishtimin, varrin edhe qortimin dhe Ditën e Gjykimit, Urën e Siratit dhe rrëshqitjen në të, pastaj sikur ta shpresonim Xhennetin dhe begatitë e tij dhe ta kujtonim Zjarrin dhe ndezjen e tij, do të ndryshohej gjendja...

Pastaj, vëllezër besimtarë të Lindjes dhe Perëndimit, të përgatitemi për takimit tonë me All-llahun e Lartësuar... Të dëgjojmë këtë rrëfim në Kur'an se si All-llahu na tregon për këtë ndodhi, për këtë udhëtim (vdekjen) ... „**Kudo që të jeni vdekja do t'ju kapë, po edhe në qofshi në kështjella të fortifikuara**”. (En-Nisa: 78) Shpejtoni me pendim, shpejtoni me kthim para se t'ju lëshojë toka dhe t'ju kaplojë vdekja.

Kjo është një e vërtetë për të cilën duhet të njoftohen njerëzit, gjë që patjetër do të ndodhë, patjetër do të ballafaqohemi me të, çdonjëri nga ju do të ballafaqohet, çdo besimtar dhe pabesimtar, çdo i largët dhe i afërt, çdo i nënçmuar dhe i pavlerë, çdo krenar dhe kryetar, çdo sundimtar dhe ministër, ky është realiteti i vdekjes, ky është stacioni i fundit, ky është përfundimi i jetës...